

Ekskluzive

Ekskluzive | E ndaloj Policia në Fushë Kosovë – 39-vjeçarit i skadoi leja e armës, i sekuestrohen Beretta, dy karikatorë dhe 24 fishekë



Sinjali.com

01 Gusht 2026 11:12



Një kontroll rutinë policor në Fushë Kosovë ka rezultuar me sekuestrimin e një arme zjarri dhe municionit, pasi u konstatua se pronari e mbante armën me leje të skaduar.

Sinjali mëson se i dyshuari është Alban Krasniqi, rreth 39-vjeçar.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur pak para mesnatës së 31 korrikut, rreth orës 23:45, në rrugën e Pejës, në fshatin Sllatinë e Madhe, ku njësitë policore ndaluan për kontroll një automjet të tipit Peugeot.

Gjatë kontrollit, Alban Krasniqi i ka njoftuar vetë zyrtarët policorë se në automjet ndodhej një armë zjarri. Pas verifikimeve, Policia ka gjetur dhe sekuestruar një pistoletë të tipit Beretta, dy karikatorë dhe 24 fishekë të kalibrit 9 mm.

Burimet bëjnë të ditur se gjatë kontrollit është konstatuar se leja e armës kishte skaduar më 21 maj 2026, çka ka bërë që arma dhe municioni të konfiskohen.

Për rastin është njoftuar Prokurorja e Shtetit, e cila ka urdhëruar iniciimin e procedurës penale për veprën “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas intervistimit në prani të avokatit mbrojtës, Alban Krasniqi është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera